




Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prilato Received / Dohirany		16.02.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRSHCK	816/2022		1/4	



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.1209/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A nr.1209/2021 të datës 22.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë:

kundër organit të punësimit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr. 1209/2021 e datës 22.12.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, sipas njoftimit për konkursë të datës 06/09/2021, me datë 21.09.2021 ka shpallur konkursin për aplikim me nr. reference RNOOOO7552 për pozitën "Udhëheqës i Prokurimit", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi cili ka kaluar testin me shkrim me sukses, i cili është mbajt me datë 03.11.2021, me datë 10.11.2021 ka pranuar ftesën për intervistë me gojë, ndërsa me datën 11.11.2021 ka pranuar njoftimin se testi me gojë nuk do të mbahet. Me datë 06.12.2021 ankuesi ka pranuar njoftimin me nr.protokolli 4802 të datës 02/12/2021, për anulimin e konkursit me arsyetimin se kanë dhënë dorëheqje kryesuesit e komisionit për vazhdimin të intervistës me gojë.

I pakënaqur me procedurën e rekrutimit lidhur me njoftimin e datës 06.12.2021 ankuesi po këtë ditë ka kërkuar me shkrim përmes E-mailit zyrtar nga Burimet njerëzore në ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që të vazhdohet me procedurë të përzgjedhjes së kësaj pozite, duke potencuar edhe pretendimet e tij për shkelje ligjore me rastin e anulimit të konkursit. Me datë 08.12.2021 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Menaxherja e Burimeve Njerëzore i është përgjigjur ankuesit lidhur me anulimin e konkursit.



Ankuesi pas përgjigjes që ka marrë nga Menaxherja e Burimeve Njerëzore, më datë 09.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4136/2 në Ministrinë e Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural , i cili me datën 20.12.2021 ka pranuar përgjigjen nga MBPZHR-së.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e datës 20.12.2021 të Ministrisë së Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datë 22.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6281/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.12.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. MBPZHR-ja, më datë 14.01.2022 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me shkresat e procedurës së zhvilluar me provat e bashkangjitura të lëndës dhe është protokolluar me numër. 163/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 22.12.2021 me numër protokolli 6281//2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, E-mail zyrtar i datës 13.01.2022, Kopja e konkursit e datës 21.09.2021, Njoftim i datës 07.10.2021 me nr.3963, Njoftimi i datës 18.10.2021 me nr.4136 , Rezultatet e vlerësimit paraprak, E-mail zyrtar i e datës, 01.11.2021, E-mail zyrtar i datës 10.11.2021, E-mail zyrtar i datës 11.11.2021, E-mail zyrtar i datës 06.12.2021, Njoftim i datës 02.12.2021 me nr.4802, E-mail zyrtar i datës 06.12.2021, E-mail zyrtar i datës 08.12.2021, Ankesë e datës 09.12.2021 ndaj anulimit të procedurës "Udhëheqës i Prokurimit", Përgjigje e datës 20.12.2021 me nr.4136/3 ndaj ankesës së ankuesit, Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 14.01.2022 me numër protokolli 163/2022 bashkë me shkresat e lëndës: Lista e aplikantëve, Lista e aplikantëve të aprovuar, Vendimi i datës 25.10.2021 me nr.4220 për formimin e Komisionit të Vlerësimit për Ngritje(avancim) në pozitë, E-mail zyrtar i datës 01.11.2021, Aplikacioni i datës 23.09.2021 për

Kopja e letërnjoftimit, Çertifikatë e datës 18.11.2011, Çertifikatë e vitit 2012-2014, Çertifikatë e datës 08.08.2012, Çertifikatë e datës 13.03.2014, Çertifikatë e vitit 2017, Çertifikatë e datës 24.09.2018, Diploma e datës 25.09.2003 me nr.333 e lëshuar nga shkolla e lartë pedagogjike në Prishtinë, Diploma e datës 22.10.2008 me nr.663 e lëshuar nga fakulteti Ekonomik, vërtetimi i kopjes nga origjinali te noteri me nr.rendor .10963/2020, Diploma e Masterit e datës 20.03.2015 me nr.657 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Kontratë për shërbime të veçanta e datës 18.07.2017, Vërtetim i datës 27.08.2018, Ndryshimi dhe Plotësimi i aktit të emërimit të datës 25.02.2016, Vërtetim i datës 12.06.2020, Kontratë pune e datës 31.08.2005, Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 e nënshkruar me datën 29.01.2021, Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 e nënshkruar me datën 26.12.2019, Vërtetim i datës 25.03.2021, Çertifikatë e viti 2020, Çertifikatë e datës 29.03.2019 ,Çertifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Vushtrri me datës 13.07.2021, Kontratë për trajnimin e të punësuarve në administratën publike e datës 21.07.2019, Kontratë për shërbime të veçanta e datës 17.10.2018, vërtetim për certifikim i datës 26.07.2021, Çertifikatë e datës 04.06.2010, Çertifikatë e datës 15.11.2005, Vërtetim i datës 25.01.2021, vërtetim i datës 07.10.2021, E-mail zyrtar i datës 10.11.2021, E-mail zyrtar i datës 11.11.2021, E-mail zyrtar i datës 06.12.2021, Njoftimi i datës 01.12.2021, Email zyrtar i datës 16.11.2021 E-mail zyrtar i datës 11.11.2021, E-mail zyrtar i datës 10.11.2021, E-mail zyrtar i datës 11.11.2021, Aplikacioni i datës 28.09.2021 për , Diploma e datës 01.09.2009 me nr.377.09 e lëshuar nga fakulteti ekonomik në Universitetin AAB, Vendim i datës 07.10.2021 me



nr.3965, Aplikacioni i datës 30.09.2021 për Cv. Çertifikatë e datës 15.09.2019, Çertifikatë e datës 30.03.2019, Çertifikatë e datës 25.03.2018, Çertifikatë e datës 04.03.2017, Çertifikatë e muajit prill 2017, Çertifikatë e vitit 2017, Mirënjohje e datës 30.12.2016, Çertifikatë e datës 03.09.2016, Çertifikatë e datës 18.07.2016, Çertifikatë e datës 23.06.2016, Çertifikatë e datës 18.11.2015, Çertifikatë e datës 11.11.2015, Çertifikatë e notave e datës 12.04.2019, Diploma master e datës 18.07.2017 me nr.1205 e lëshuar nga fakulteti ekonomik në Universitetin e Prishtinës, Diplomë e datës 15.09.2015 me nr.5536 e lëshuar nga fakulteti ekonomik dhe Akt emërimi i datës 02.03.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit dhe analizimit të provave të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Kryesuesi i komisionit për vlerësimin për ngritje (avancim) me rastin e dorëheqjes është arsyetuar se pasi që Komisioni i vlerësimit për ngritje në pozitë është themeluar në kundërshtim me nenin 59 të Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se *"1.Në tekstin e mëtejme: "KVND") themelohet për secilën procedurë konkurrimi për ngritjen në detyrë. 2 KVND themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit, me propozim të NJBNJ .3 KVND ka në përbërje këta anëtarë: 3.1. një përfaqësues i Njesisë Përgjegjëse (DMZP-ja për institucionet e administratës shtetërore apo Njësia e Burimeve Njerëzore të Institucionit për institucionet e tjera shtetërore) i specializuar në teknikat e përzgjedhjes. 3.2. një përfaqësues nga NJBNJ e vetë institucionit që ka pozitën e lirë; 3.3. një nëpunës civil i kategorisë të lartë drejtuese të vetë institucionit apo të një institucioni tjetër të shërbimit civil, me përgatitje të veçantë në procedurat e përzgjedhjes"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar se në përgjigje në ankesë të datës 14.01.2022 menaxherja e burimeve njerëzore e organit të punësimit në këtë rast Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjigjë se anulimi i konkursit është rezultat i dorëheqjes së kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të komisionit ,duke pasur parasysh që shumica e procedurës është zhvilluar nga personi tjetër. Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullorja (QRK) NR. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shprehimisht e rregullojnë çështjen e përbërjes së komisionit bazuar në nenin 59 të Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në kuadër të komisionit të vlerësimit për ngritje në detyrë duhet të jetë edhe një nëpunës civil i kategorisë të lartë drejtuese të vetë institucionit apo të një institucioni tjetër të shërbimit civil, me përgatitje të veçantë në procedurat e përzgjedhjes, ndërsa pozitë e këtij niveli nuk është drejtori i departamentit nga se kjo çështje është e rregulluar edhe përmes Rregullores (QRK) NR. 26/2020,për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil dhe at nenit 4.1 të kësaj rregullore në të cilën definohet kategorizimi i niveleve dhe at si në vijim; *"1. Në pajtim me Ligjin, pozitat e punës në shërbimin civil të Kosovës ndahen në këto kategori funksionale: 1.1. Kategoria e Lartë Drejtuese; 1.2. Kategoria e Mesme Drejtuese; 1.3. Kategoria e Ulët Drejtuese, dhe 1.4. Kategoria Profesionale"*,poashtu neni 5 i kësaj rregullore definon kuptimin e e kategorisë së lartë drejtuese: *"1. Kategoria e Lartë Drejtuese është kategoria më e lartë e menaxhimit të një institucioni, që ka përgjegjësinë për hartimin e politikave dhe këshillimin rreth tyre.."*. Në nenin 10 të kësaj rregullore specifikohen emërtimet e këtyre pozitave,ndërsa në nenin 11 përcaktohen Klasat



përbërëse të kategorisë të Mesme Drejtuese, pika 3 specifikon edhe pozitën **“3. Drejtor Departamenti në një Ministri”**.

Kolegji bazuar në dispozitat ligjore të specifikuara më lartë konstaton se komisioni sipas vendimit Ref:999/Nr.757 të datës 25/10/2021 është në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 të Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nga se në përbërje të komisionit nuk ka qenë asnjë anëtar sipas pikës 3.3 të kësaj rregullore, dhe poashtu baza ligjore e nxjerrjes së vendimit sa i përket komisionit i referohet nenit 46 të Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, që është i ndryshëm nga komisioni i vlerësimit për ngritje në detyrë, andaj vendimi për anulim të konkursit është i bazuar.

Kolegji vlerëson se më faktin se janë konstatuar këto shkelje në përbërje të komisionit anulimi i konkursit ka qenë i pashmangshëm, e që fakt u konstatua edhe me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese por se organi i punësimit duhet me kujdes të shtuar dhe plotësisht në harmoni me ligjin e zyrtarëve publik dhe aktet nënligjore të themelohet komisionet e regrutimit, dhe poashtu edhe anëtarët e komisionit me kohë ka qenë dashtë të rishqyrtojnë pozicionin e tyre në komision nëse kanë vlerësuar se nuk është në harmoni me dispozitat ligjore, nga se krijohet një pasiguri juridike në këto procese ku pësojnë shërbyesit civil pa fajin e tyre, andaj i mbetet organeve kompetente të Ministrisë që të shqyrtojnë ndërmarrjen e veprimeve ligjore ndaj zyrtarëve që kanë shkaktuar këtë situatë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndal ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.1209/2021, 16.02.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Ankuesit,
- ❖ Sekretarët të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe
- ❖ Arkivat të KPMSHCK-së